



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 34, datë 16.04.2024

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI”  
ZOTIT MIRUSH KABASHI (PAS VDEKJES)

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 94/2022, “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni Këshillimor i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 86, datë 19.03.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:



1. T'i jepet titulli “Qytetar Nderi ”

**Z. Mirush Kabashi (Pas vdekjes)**

me motivacionin :


*“Personalitet i lartë dhe i shquar në fushën e artit, kulturës, edukimit, politikave kulturore, qytetar model, artist i madh i kinematografisë, skenës dhe ekranit”.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Arsim, Kulturë, Sport, Rini dhe Komunitete Fetare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 17.04.2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 236 Prot.  
2

Durrës, më 17.042024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërise së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**



**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.34 datë 16.04.2024 “Për dhënien e titullit “Qytetar nderi” Zotit Mirush Kabashi (pas vdekjes)”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

